

VENDIM
Nr. 47, datë 1.2.2023

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, PËR ZHVILLIMIN
E PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS, SIGURISË LOGJISTIKE DHE
EFICIENCËS SË TRANSPORTIT TË MALLRAVE NDËRMJET DY VENDEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për zhvillimin e projekteve të infrastrukturës, sigurisë logjistike dhe eficiencës së transportit të mallrave ndërmjet dy vendeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, PËR ZHVILLIMIN E
PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS, SIGURISË LOGJISTIKE DHE EFICIENCËS
SË TRANSPORTIT TË MALLRAVE MES DY VENDEVE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (këtëj e tutje referuar si “Palët”), me dëshirën që të bashkëpunojnë në kuadrin e funksioneve, qëllimeve dhe juridiksioneve të tyre,

duke vlerësuar rëndësinë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, forcimin e sundimit të ligjit në ekonomitë respektive dhe funksionalizimin e një tregu të hapur rajonal të integruar me atë evropian;

në kuadër të përpjekjeve të gjithanshme për mbrojtjen e qytetarëve dhe sipërmarrjeve të dy vendeve nga efektet negative dhe distorcionet e shkaktuara nga lufta në Ukrainë, tregjet e energjisë dhe pengesat në zinxhirin ndërkombëtar të furnizimit;

duke konsideruar se bashkëpunimi i tyre do të ndihmojë në realizimin e përgjegjësive edhe në funksion të bashkëpunimit të deritanishëm midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të lehtësojë ushtrimin e katër lirive themelore të qytetarëve të vendeve tona, dhe veçanërisht lirinë e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave,

kanë rënë dakord si vijon.

Neni 1
Qëllimi

Kjo Marrëveshje ka si qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë për zhvillimin e projekteve konkrete në funksion të përmirësimit të ndërlidhjes infrastrukturore, eficiencës së transportit në ngarkesat

tranzitore ndërmjet porteve tregtare shqiptare dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe sigurisë së zinxhirit të furnizimeve në rajon.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

1. Palët në bashkëpunim, përmes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të sigurojnë një studim fizibiliteti për ndërtimin e një zone logjistike intermodale, në formën e portit të thatë, në afërsi të Strugës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për përpunimin e ngarkesave tranzitore që vijnë në Maqedoninë e Veriut përmes kompleksit portual Durrës–Porto-Romano.

2. Palët, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në tremujorin e parë nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, obligohen të përcaktojnë një plan masash për thjeshtimin e procedurave për realizimin e kësaj Marrëveshjeje, ulje të kohës dhe shpenzimeve në transport, rritje të efektivitetit në shpërndarjen e mallrave, si dhe mundësimin e zhdoganimit të ngarkesave, me destinacion Republikën e Maqedonisë së Veriut, në portet shqiptare ku ato tranzitojnë.

3. Palët do të bashkërendojnë në përpjekjet e tyre, me të gjitha instancat e Bashkimit Evropian dhe ato rajonale, për përfshirjen e infrastrukturës dhe korridoreve të transportit mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, në hartën e nyjave kryesore të ndërlidhjes së Bashkimit Evropian.

4. Në kontekstin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, palët do të ndërmarrin hapa të përbashkët, me synim bashkëfinancimin e projekteve të ndërlidhjes infrastrukturore për funksionalizimin e Korridorit Evropian VIII.

Neni 3

Format e bashkëpunimit

Palët do të shkëmbejnë informacionin dhe eksperiencën sipas legjislacioneve rregulluese respektive, për nxitjen e një bashkëpunimi efektiv dhe bien dakord të bashkëpunojnë në çështjet e mëposhtme:

1. Të krijojnë procedura koordinimi dhe informacioni, me anë të të cilave palët ndihmojnë njëra-tjetrën për qëllimet e përbashkëta;

2. Të organizojnë veprimtari të përbashkëta në funksion të qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje;

3. Të ndërmarrin bashkërisht hapat e nevojshëm pranë institucioneve të Bashkimit Evropian, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe atyre të bashkëpunimit rajonal për jetësimin e objektivave të parashikuar në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Ligji i zbatueshëm

Aktivitetet e kryera në pajtim me këtë Marrëveshje, në mënyrë të veçantë për ndarjen e informacionit dhe pjesëmarrjen në veprime të përbashkëta, do të kryhen në përputhje me legjislacionin rregullues të Palëve.

Neni 5

Gjuha

Shkëmbimet zyrtare të informatave do bëhen në mënyrë të drejtpërdrejtë, mes ministrive përkatëse, në mënyrë që do të dakordësohen palët, në gjuhën shqipe dhe maqedonase.

Neni 6
Ndryshimet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet apo plotësohet vetëm me shkrim nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të Palëve. Ndryshimi do të hyjë në fuqi në datën kur njoftohet dhënia e pëlqimit nga pala tjetër.

Neni 7
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo Mosmarrëveshje në interpretimin dhe në zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje zgjidhet nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve.

Neni 8
Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën mbi përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme që nevojiten për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje është nënshkruar në Tiranë, më 12.12.2022, në gjuhën shqipe dhe maqedonase, ku të dyja tekstet në mënyrë të barabartë janë autentike.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Belinda Balluku

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Artan Grubi